



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno / Prodato Received / Delivered	12.04	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No	Entregje Faqja Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSCHK/3486/2023			113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.418/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.418/2023 të datës 24.02.2023 të parashtruar nga ankuesi _____, kundër organit të punësimit Komunës së Lipjanit, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 12.04.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.418/2023 e datës 24.02.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Nëpunësi civil _____ i punësuar në Komunën e Lipjanit, përmes e-mailit ankesa.kpmschk@rks-gov.net më datë 24.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2067/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes të datës 19.01.2023 të organit të punësimit Zyrës së Personelit të Komunës së Lipjanit lidhur me refuzimin e kërkesës së ankuesit për kompensimin e mjeteve financiare në mënyrë retroaktive në emër të diferencës së koeficienti të pagës nga gjashtë (6) në tetë (8) nga data 20.11.2014 e deri me 31.12.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 03.03.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Lipjanit. Ndërsa Këshilli me datë 14.03.2023 përmes emalit ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 2067/2023 të datës 24.02.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesë e ankuesit drejtuar zyrës së personelit në Komunën e Lipjanit me numër protokollit 1-120/02-2979 i datës 17.01.2023; Përgjigje në kërkesë nga zyra e personelit në Komunën e Lipjanit e datës 19.01.2023; Vendim i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokollit 8423/2022 i datës 23.12.2022; Akt Emërimi i datës 10.07.2013; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 03.03.2023; E-mail nga për i datës 14.03.2023; Përgjigje në ankesë e datës 13.03.2023; Akt Emërimi me numër .Nr.1-120/04-1287 i datës 10.01.2023; Lista e pagave prej 01.01.2023 deri 31.01.2023; Lista e pagave prej 01.02.2023 deri 28.02.2023; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 09.10.2012;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Nga provat e administruara të lëndës rrjedhë se ankuesi është i punësuar në Komunën e Lipjanit në pozitën e punës "Inspektor i Mjedisit-Ambientit". I njëjti më datë 07.12.2022 kishte parashtruar ankesë për harmonizimin e koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në koeficientin tetë (8), në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa ky i fundit me Vendimin A.nr.1108/2022 të datës 23.12.2022 ka aprovuar ankesën e ankuesit si të bazuar dhe ka obliguar organin e punësimit që ankuesit t'ia harmonizoj koeficientin e pagës me titullin e pozitës dhe përshkrimin e vendit të punës nga gjashtë (6) në tetë (8), ku si rrjedhojë organi i punësimit konkretisht Komuna e Lipjanit, më datë 10.01.2023 ankuesit i ka lëshuar Akt Emërimin .Nr.1-120/04-1287 me koeficient tetë (8).

Ankuesi më datë 17.01.2023 ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësja e Personelit të Komunës së Lipjanit për kompensimin retroaktiv të diferencës së koeficientit për pjesën e humbur të pagës që nga data 20.11.2014 e deri me 31.12.2022. Udhëheqësja e Personelit përmes përgjigjes së datës 19.01.2023 ka refuzuar kërkesën e ankuesit të datës 17.01.2023 me arsyetimin se koeficienti i pagës tetë (8) do të vlejë vetëm nga data e zbatimit të vendimit të Këshillit.

I pakënaqur me përgjigjen e datës 19.01.2023 të organit të punësimit Zyrës së Personelit të Komunës e Lipjanit, ankuesi me datë 24.02.2023 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për kompensimin e mjeteve financiare në mënyrë retroaktive në emër të diferencës së koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në tetë (8) në vlerën e dy koeficienteve në harmoni me shkresën DASHC/MAP-04/1571 02/ZSP /3851 të datës 20.11.2014 duke filluar nga data 20.11.2014 e deri me 31.12.2022.

Kolegji i Këshillit, shqyrtoj pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me kompensimin e diferencës së dy koeficienteve të pagës në mënyrë retroaktive, dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit si i tillë nuk është i bazuar, ngase sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedh se ankuesi me datë 10.07.2013 ka nënshkruar pa vërejtje aktin e emërimit për pozitën e punës "Inspektor i Mjedisit-Ambientit" me koeficient të pagës gjashtë (6), dhe se i njëjti edhe përkundër faktit se ka qenë në dijeni lidhur me koeficientin e përcaktuar të pagës nuk ka ndërmarr asnjë veprim juridik në kuptim të harmonizimit të koeficientit të pagës me vendin e punës deri me datë 17.01.2023, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative (ligj ky i aplikueshëm në kohën kur ankuesi kishte nënshkruar aktin e emërimit me datë 10.07.2013), përkatësisht nenin 130 të këtij ligji ku përcaktohej se: 130.1. Ankimi



administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin.

Rrjedhimisht nisur nga dispozitat e lartshënuar, ankuesi ka humbur afatin, por Kolegji konstaton se nga data 20.11.2014 e deri me 31.12.2022 ankuesi është kompensuar konform akt emërimit të cilin e ka pasur të nënshkruar, dhe i njëjti nga data 23.12.2022 kompensohet sipas akt emërimit me ndryshime prandaj ankuesi nuk ka asnjë bazë ligjore që të kërkoj kompensimin retroaktive sepse nuk asnjë dëshmi të vetme se i është shkelur e drejta në pagë sipas akt emërimit.

Prandaj, duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.418/2023

Çlirim ZEKA

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

Ankuesit

Kryetarit të Komunës së Lipjanit

Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Lipjanit; dhe

Arkivit të KPMSHCK-së